



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorëzuar Prilimjen / Prodato Received / Delivered	30.08.2022	2	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinitca Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënjë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5039	2022	119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.624/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.624/2022 të datës 15.07.2022 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me numër protokollit 2446 të datës 01.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa A.nr.624/2022 e datës 15.07.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet** Vendimi me numër protokollit 2446 i datës 01.07.2022 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- III. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën: "Zyrtare e Lartë e Personelit". E njëjta përmes Vendimit me numër protokollit 2446 të datës 01.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është transferuar përkohësisht në pozitën "Zyrtare e Lartë për Legalizimi dhe Çertifikim" pranë Departamentin për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 01.07.2022 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 15.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se vendimi i atakuar është i kundërligjshëm për shkak të mohimit të drejtave elementare të punës dhe mohimit të njoftimit paraprak.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar me datë 20.07.2022 për përgjigje në ankesë në MPJD. Këshilli, me datë 29.07.2022 përmes e-maili ka pranuar përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar me datë 02.08.2022 dhe po ashtu me datë 03.08.2022 ka pranuar prova shtesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 15.07.2022, me numër protokollit 4153/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me e-mailin e bashkangjitur; Vendimin me numër protokollit:2446 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 01.07.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2019; Vendimin e datës 22.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin e datës 23.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin e datës 10.05.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me numër:25/2022; Akt emërimin e ankueses të datës 13.06.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e akt të emërimit të datës 10.06.2013; Akt emërimin e datës 20.07.2012; Kontratën e marrëdhënies së punës të datës 01.07.2009; Kontratën e marrëdhënies së punës të datës 30.06.2011; E-mailin e datës 04.07.2022 dërguar nga Xh.G për F.S; E-mailin e datës 04.07.2022 dërguar nga ankuesja për Xh.G; Përgjigjen në kërkesë me shkresat e lëndës e datës 03.08.2022; Vendimin e me numër prot:1982 të Zëvendës Kryeministres dhe Ministres së Ministrisë për Punë të Jashtme dhe Diasporës i datës 06.06.2022; E-mailin e datës 27.06.2022 dërguar nga B.I për V.B; E-mailin e datës 27.06.2022 dërguar nga F.S për B.I me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 01.07.2022 dërguar nga A.M për ankuesen; Vendimin e datës 20.07.2012 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJ-së; Vendimin e datës 10.06.2013 të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJ-së; E-mailin e datës 29.07.2022 dërguar nga V.B për këshillin me provat e lëndës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 20.07.2022; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses

është e bazuar, sepse:



Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimin e datës 13.06.2022 ka konstatuar se ankuesja, është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pozitën e punës *Zyrtare e Lartë e Personelit*, ndërsa e njëjta me Vendimin me numër protokollit 2446 të datës 01.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm është transferuar përkohësisht nga data 01.07.2022 deri me datë 31.12.2022 në pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Legalizimi dhe Çertifikim*. Transferimi është realizuar pas kërkesës të datës 27.06.2022 të Drejtorit të Departamentit për Çështje Konsullore.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, për shkak të mohimit të drejtave elementare të punës dhe mohimit të njoftimit paraprak.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuses, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 2 paragrafin 2.1 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale, dhe rrjedhimisht vlerëson se organi i punësimit ka të drejtë që nëpunësin civil ta transferojë përkohësisht për interes të institucionit, mirëpo në kuptim të nenit 52 paragrafi 7 të njëjtit ligj, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Kolegji konstaton se transferimi i përkohshëm në interes të institucionit është në kompetencë të njësisë përgjegjëse.*

Sipas dispozitave të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, njësi përgjegjëse në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është Njësia për Burime Njerëzore. Njësia e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse në rastet e tilla njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet, dhe se për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se vendimi për transferimin e ankuses nga pozita e punës *Zyrtare e Lartë e Personelit*, në pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Legalizimi dhe Çertifikim* nuk është miratuar nga organi kompetent, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore, dhe rrjedhimisht nga organi i punësimit nuk është dhënë asnjë arsytim në lidhje me marrjen e kompetencës së njësisë përgjegjëse nga udhëheqësi me i lartë administrativ. Andaj bazuar në këtë konstatim, Kolegji i Këshillit vlerëson se akti i kontestuar është nxjerr nga organi jo kompetent dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.624/2022**

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së